

Nr.	Drejtoria/Struktura	Detyrat funksionale të drejtorisë	Drejtori
1.	Drejtoria e Procedurave të Rekrutimit në Shërbimin Civil	Kjo drejtori ka në përgjegjësi zbatimin e detyrimeve të Departamentit të Administratës Publike në cilësinë e "njësisë përgjegjëse", në kuptimin e ligjit nr. 152/2013, të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, e konkretisht për: - Organizimin e procedurave të rekrutimit për kategorinë ekzekutive, si dhe të ulët e të mesme drejtuese. - Organizimin e procedurave të rekrutimit dhe menaxhimit të Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues (TND) në institucionet e administratës shtetërore. - Menaxhimin e proceseve që lidhen me emërimet, lirimet, transferimet, pezullimet, konfirmimet e nëpunësve civilë në institucionet e administratës shtetërore. - Administrimin e planit vjetor të pranimi në shërbimin civil për institucionet e administratës shtetërore. - Mbështetjen e Komiteteve të Përhershme të Pranimi, Komiteteve të Pranimi për Lëvizjen Paralele, si edhe të Komiteteve të Pranimi për Ngritjen në Detyrë. - Administrimin e të dhënave në lidhje me emërimet, lirimet, pezullimet, transferimet, masat disiplinore dhe çdo lëvizje tjetër në institucionet e administratës shtetërore duke mbajtur rekordet përkatëse. Gjithashtu, kjo drejtori luan rolin e Sekretariatit Teknik për Komitetin Kombëtar të Përzgjedhjes për Trupën e Nivelit të Lartë Drejtues.	Znj. Migena Braçe Znj. Migena Braçe është pjesë e Departamentit të Administratës Publike që prej muajit Maj 2016 dhe mban pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Procedurave të Rekrutimit në Shërbimin Civil që nga muaji Nëntor 2023. Është diplomuar si Psikolog Pune pranë Fakultetit të Psikologjisë nr. 2, Universiteti “La Sapienza”, Romë, Itali në profilin “Burimet njerëzore, psikologjia organizative dhe e punës”.
2.	Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit të Administratës Publike	Kjo drejtori ka në përgjegjësi: - Hartimin e politikave të qeverisë shqiptare në fushën e ndërtimit të institucioneve (i) standardet e krijimit dhe organizimit të institucioneve të administratës publike; (ii) reforma funksional strukturore e institucioneve të administratës shtetërore; (iii) standardet dhe ndjekjen e zbatimit	Znj. Keida Meta Znj. Keida Meta është pjesë e Departamentit të Administratës Publike që prej muajit Gusht 2015 dhe mban pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Politikave dhe Zhvillimit të Administratës Publike që nga muaji Janar 2024. Është diplomuar “jurist”

		të tyre në lidhje me analizën e proceseve (manuali i procedurave). • Hartimin e politikave të qeverisë shqiptare në fushën e pagave, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për financat; • Hartimin e politikave të qeverisë shqiptare në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore: (i) performanca; (ii) udhëzime, manuale për proceset e parashikuara në legjislacionin e nepunësit civil; (iii) hartimi i akteve ligjore dhe nënligjore për fushën e shërbimit civil dhe interpretime të ndryshme. • Hartimin e politikave të qeverisë shiptare në fushën e rritjes profesionale të administratës publike si: energjizimi, trajnimi, motivimi, ndërveprimi i administratës publike në përgjithësi. • Përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore, ndërtimit të institucioneve dhe pagave. • Dhënien e mendimit për strukturat dhe organikat e institucioneve te pavarura, si dhe për strukturat dhe organikat e institucioneve të administratës shetërore që miratohen nga Këshilli i Ministrave apo bordet/këshillat drejtuese të agjencive autonome.	pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Gjithashtu, ka kryer studimet në programet Master i Nivelit të Dytë në “E drejtë kushtetuese, e krahasuar dhe evropiane” dhe Master Profesional në "Administrim publik". Znj. Meta ka një eksperiencë të vyer në menaxhimin e burimeve njerëzore si dhe në lidhje me politikat e zhvillimit të institucioneve të administratës shtetërore.
3.	Drejtoria e Programeve të Reformës në Administratën Publike	Kjo drejtori ka në përgjegjësi hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të programeve dhe projekteve në fushën e reformës së administratës publike, e konkretisht: • Programet e modernizimit në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore - ndërveprimi, unifikimi i proceseve, etj. • Programet e qeverisjes së mirë dhe jetësimit të prioritetëve:	Z. Ened Kërçini Z. Ened Kërçini është pjesë e Departmentit të Administratës Publike që prej vitit 2014 dhe mban pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Programeve të Reformës në Administratën Publike. Ai është diplomuar për Inxhinieri Elektronike pranë Universitetit

		(i) Strategjia Ndërsektoriale e Reformës së Administratës Publike dhe koordinimi i saj; (ii) koordinimi i programeve të ndryshme në lidhje me zhvillimin e menaxhimit të burimeve njerëzore, përfshirë raportimin me donatorët dhe me organizma të tjerë ndërkombëtare; (iii) ndjekja e detyrimeve që DAP ka në strategji të tjera përveç asaj të administratës publike; (iv) programet IPA • Projektet - identifikimi dhe inicimi i projekteve në përputhje me programin dhe strategjitë e zhvillimit, hartimi i projekteve të plota (që përfshijnë projektet teknike), vlerësimi i fizibilitetit të tyre, vlerësimi i impakteve etj. Gjithashtu, kjo drejtori është përgjegjëse për të siguruar administrimin dhe mirëfunksionimin e Regjistrit Qendror të Personelit, si dhe ushtron çdo kompetencë të përcaktuar në ligjin nr. 152/2013, të ndryshuar dhe VKM nr. 117/2014, në lidhje me këtë sistem.	Politeknik të Tiranës në vitin 1993. Z. Kërçini vjen nga një eksperiencë rreth 15 vjeçare në sektorin privat.
4.	Drejtorja e Integritetit, Mbikqyrjes dhe Ankesave Administrative e Gjyqësore	Kjo drejtori, bazuar në legjislacionin mbi integritetin e nëpunësve publikë, si dhe në legjislacionin e nëpunësit civil, ka në përgjegjësi: • Ndjekjen dhe zbatimin e detyrimeve në bazë të legjislacionit për integritetin e nëpunësve publikë; • Mbikqyrjen e zbatimit të legjislacionit për nëpunësin civil në institucionet e administratës shtetërore pjesë të fushës së veprimit të legjislacionit për nëpunësin civil; • Ndjekjen e proceseve që kanë të bëjnë me procedurat e masave disiplinore në	Znj. Marcela Kërëku Znj. Marcela Kërëku është pjesë e Departamentit të Administratës Publike nga muaji maj 2015 – qershor 2016 dhe janar 2018 e në vijim mban pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Integritetit, Mbikëqyrjes dhe Ankesave Administrative e Gjyqësore që nga muaji shtator 2019. Është diplomuar pranë

		institucionet e administratës shtetërore pjesë e fushës së veprimit të legjislacionit për nëpunësin civil; • Ndjekjen e proceseve gjyqësore për nëpunësit civilë në institucionet e administratës shtetërore.	Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës si juriste dhe Fakultetit të Gjuhë – Letërsi për mësuesi. Ka ndjekur më pas specializimin 3 mujor në Akademinë Amerikane të Ligjit Ndërkombëtar në Dallas/USA si dhe në Shqipëri Masterin Shkencor “E drejta Publike”.
--	--	--	--